

VENDIM
Nr. 860, datë 27.12.2022

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 11.6.2019, PËR ÇËSHTJEN “PRIZRENI KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 29309/16)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 11.6.2019, për çështjen “Prizreni kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 29309/16, përfundimtar në datën 11.9.2019, në shumën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, si dhe në shumën 1 450 (një mijë e katërqind e pesëdhjetë) euro, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuarit Fatos Prizreni, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 11.6.2019, “Prizreni kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 29309/16.

4. Pagimi i shumës të depozituar, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuarit Fatos Prizreni, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

5. Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 12.12.2019, deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi, të paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2022.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama